



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0330

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Kryetare, Vedat Poterqoi Anetar, Agon Ramadani Anetar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Ramë Haklaj B.I.”, me seli në Deqan, kundër njoftimit për kontratë dhe dokumenteve të dosjes së tenderit të Komuna e Gjakovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Hapësirave Publike në Qendër të Qytetit” me numër të prokurimit 632-23-4780-5-1-1, me 07/07/2023 mori:

Vendim

1. Aprovohet, kërkesa e datës 05/07/2023, e parashtruar nga Ramë Haklaj B.I., për tërheqjen e ankesës me nr. 2023/0330, e datës 31/05/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Hapësirave Publike në Qendër të Qytetit”, me numër të prokurimit 632-23-4780-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës.
2. I lejohet, autoritetit kontraktues – Komuna e Gjakovës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Hapësirave Publike në Qendër të Qytetit”, me numër të prokurimit 632-23-4780-5-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.
3. Meqenëse parashtruesi i ankesës është tërhequr nga ankesa pas pranimi të raport të ekspertit shqyrtues, duke u bazuar në nenin 28.1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, këtij OE, në emër të shpenzimeve procedurale i konfiskohet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimi të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Ramë Haklaj B.I.”, me 31/05/2023, kishte parashtruar ankesë në OSHP (Nr. të protokollit 2023/0330) kundër njoftim për kontratë dhe dosjes së tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Hapësirave Publike në Qendër të Qytetit” me numër të prokurimit 632-23-4780-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) - Komuna e Gjakovës, në

cilësinë e autoriteti kontraktues, duke pretenduar në shkelje të neneve: 1, 7, 27, 69, 60, dhe nenin 108/A i LPP-së, si dhe nenin 17 dhe nenin 25 të Rregullores Nr.001/2022 për prokurim publik.

OE “Ramë Haklaj B.I.”, me 05.07.2023, me imell e ka njoftuar OSHP-në se është tërhequr nga ankesa me numër 2023/0330/23, ankesë e cila ka qenë e parashtruar në OSHP-ë, me datë 31.05.2023.

Kryetarja e paneli shqyrtues pas informimit lidhur me kërkesën e tërhequr nga operatorit ekonomik në këtë fazë ankues “Ramë Haklaj B.I.”, mori vendim me të cilin e aprovon kërkesën e Ankuesit për tërheqje nga ankesa respektivisht pretendimet ankimore të ankesës Nr. 2023/0330 të datës 31.05.2023.

Meqenëse parashtruesi i ankesës është tërhequr nga ankesa pas pranimi të raport të ekspertit shqyrtues, duke u bazuar në nenin 28.1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, këtij OE, në emër të shpenzimeve procedurale i konfiskohet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimi të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Megjithatë PSH e obligon AK që të bëjë verifikimin e kërkesave të vendosura në DT konform dispozitave ligjore të LPP-së dhe përgjigjeve të dhëna në raportin e ekspertizës nga eksperti shqyrtues në mënyrë që hartimi i dosjes së tenderit të bëhet konform nenit 27 të këtij ligji.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - Ramë Haklaj B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: